

SPECIFIKIME TEKNIKE:**MONITORIMI I TREGUESVE MJEDISORË NË TRE NJËSITË PRODHUESE NËN ADMINISTRIMIN E KESH sh.a****1. Përshkrim i përgjithshëm**

KESH sh.a. ka në administrim kaskadën më të madhe në rajon me një sipërfaqe ujëmbledhëse në Lumin Drin, e cila vlerësohet të jetë 14,173 km² më një gjatësi të rrjedhës prej 285 km.

KESH ka nën administrim impiantet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në vend dhe si veprimtari themelore prodhimin e energjisë elektrike dhe tregtimin e saj.

HEC Fierza është hidrocentrali i sipërm i kaskadës së lumit Drin. Për nga fuqia e instaluar, pozicioni dhe vëllimi i rezervuarit, Fierza luan rol kyç për shfrytëzimin, rregullimin dhe sigurinë e gjithë kaskadës dhe ka një fuqi të instaluar prej 500 MW (4 x 125 MW).

HEC Koman është hidrocentrali i dytë dhe më i fuqishëm i kaskadës së lumit Drin. Për nga fuqia e instaluar, pozicioni dhe vëllimi i rezervuarit, ky HEC luan rol kyç për prodhimin dhe shfrytëzimin e të gjithë kaskadës. Komani është hidrocentrali me kapacitetin më të madh të prodhimit të energjisë në vendin tonë dhe ka një fuqi të instaluar prej 600 MW (4x150 MW).

HEC Vau i Dejës është hidrocentrali i parë që u ndërtua mbi lumin Drin dhe ka një fuqi të instaluar prej 250 MW. Ai ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë, në rrjedhën e poshtme të lumit Drin, në Grykën e Vaut të Dejës, rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës.

Me miratimin e marrëveshjes së huas me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Ristrukturimi i KESH sh.a.”, që prej vitit 2016, KESH ka nisur aplikimin dhe zbatimin e procedurave të Sistemit të Menaxhimit të Integruar të sistemeve të mëposhtme, të cilat janë detyrim i kësaj marrëveshjeje:

- UNI EN ISO 9001- Sistemi i menaxhimit të cilësisë,
- UNI EN ISO 14001 - Sistemi i menaxhimit të mjedisit,
- ISO 45001 - Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe

Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 kërkon që:

- aktivitetet në njësitë prodhuese të shoqërisë të jenë në përputhje me ligjet dhe kërkesat mjedisore në fuqi;
- shoqëria menaxhon në mënyrë rigorozë impaktet për një zhvillim të qëndrueshëm të performancës mjedisore;

- shoqëria trajnon dhe ndërgjegjëson punonjësit për menaxhimin e impakteve gjatë aktiviteteve në njësi.

KESH sh.a. është e angazhuar, për këtë arsye, për të siguruar disponueshmërinë e burimeve dhe informacionit të nevojshëm për të arritur rezultatet e planifikuara përmes zbatimit të masave që kanë për qëllim monitorimin, matjen dhe analizimin e proceseve të identifikuar. Specifikimet e mëposhtme janë përgatitur me qëllim vlerësimin e disa prej treguesve mjedisorë, që duhet të kryhet nga laboratorë të specializuar dhe të akredituar. Rezultatet e analizave do t'u bashkohen proceduarave të ISO 14001, me qëllim marrjen e këtij certifikimi, duke filluar me Auditimin Certifikues Fillestar.

2. Përshkrimi i shërbimit dhe specifikimet teknike

2.1 Matja e cilësisë së ajrit në ambientet e jashtme

Cilësia e ajrit në ambientet e jashtme matet në tre njësitë prodhuese, përkatësisht në këto pika:

- ekonomia e vajrave
- afër sallës së makinerive.

Parametrat që do të maten në secilën pikë matje:

- matje të gazeve në ajër të mjediseve të punës të brendshme dhe të jashtme për gazet CO, CH₄/LEL, O₂, VOC, H₂S.
- Përcaktimi i përqendrimit të grimcave (TSP, P M 10, PM_{2.5}) në ajër të mjediseve të punës të brendshme dhe të jashtme me metodë gravimetrike.
- *Ndotja akustike: Parametrat LAeq, LAmax në mjedis dhe në mjedis të punës.*

Prova	Metoda	Fusha e matjes
CO	S SH EN 45544-2:2015	0-2000 ppm
CH ₄ /LEL	S SH EN 45544-2:2015	≥ 1%
O ₂	S SH EN 45544-2:2015	0-20.9%
VOC	S SH EN 45544-2:2015	0-1000 ppm
H ₂ S	S SH EN 45544-2:2015	0-200 ppm
TSP	S SH EN 12341 : 2014	1 µg/m ³ - 150 mg/m ³
PM ₁₀	S SH EN 12341 : 2014	1 µg/m ³ - 150 mg/m ³
PM _{2.5}	S SH EN 12341 : 2014	1 µg/m ³ - 150 mg/m ³
Niveli i zhurmës Laeq dhe LAmax	S SH EN ISO 1996-2:2017	30-144 dB (A)

Niveli i zhurmës në mjediset e punës	S SH EN ISO 9612-2:2009	30-143 dB (A)
--------------------------------------	-------------------------	---------------

Shënim: fusha e matjes të jetë më e gjerë se ajo e përcaktuar në tabelën më sipër, por jo më e vogël.

- **2.2 Matja e cilësisë së ajrit në ambientet e brendshme**

Kryhet në tre njësitë prodhuese, përkatësisht në tetë pika:

- galeritë e drenazheve
- galeritë e thellësive,
- salla e turbinave dhe e kompresorëve,
- salla e komandës,
- sheshi i montimit,
- salla e baterive,
- galeritë e digave,
- ambientet e administratës.

Parametrat që do të maten në secilën pikë matje:

- matje të gazeve në ajër të mjediseve të punës të brendshme dhe të jashtme për gazet CO, CH₄/LEL, O₂, VOC, H₂S.
- Përcaktimi i përqendrimit të grimcave (TSP, P M 10, PM_{2.5}) në ajër të mjediseve të punës të brendshme dhe të jashtme me metodë gravimetrike.
- *Ndotja akustike: Parametrat LAeq, LAmx në mjedis dhe në mjedis të punës.*

Prova	Metoda	Fusha e matjes
CO	S SH EN 45544-2:2015	0-2000 ppm
CH ₄ /LEL	S SH EN 45544-2:2015	≥ 1%
O ₂	S SH EN 45544-2:2015	0-20.9%
VOC	S SH EN 45544-2:2015	0-1000 ppm
H ₂ S	S SH EN 45544-2:2015	0-200 ppm
TSP	S SH EN 12341 : 2014	1 µg/m ³ - 150 mg/m ³
PM ₁₀	S SH EN 12341 : 2014	1 µg/m ³ - 150 mg/m ³
PM _{2.5}	S SH EN 12341 : 2014	1 µg/m ³ - 150 mg/m ³

Niveli i zhurmës Laeq dhe L _{Amax}	S SH EN ISO 1996-2:2017	30-144 dB (A)
Niveli i zhurmës në mjediset e punës	S SH EN ISO 9612-2:2009	30-143 dB (A)

Shënim: fusha e matjes të jetë më e gjerë se ajo e përcaktuar në tabelën më sipër, por jo më e vogël.

2.3 Vlerësimi i cilësisë së ujit

Ujërat e shkarkuara nga njësitë prodhuese nuk duhet të kenë përmbajtje të larta ndotësish (vajrash, hidrokarburesh, ose kimikatesh) që vijnë nga proceset e ndryshme gjatë aktivitetit në njësi. Për këtë arsye, ujërat që drenohen nga mjediset përreth njërive prodhuese duhet të testohen për t'u siguruar që ndotësit e ndryshëm nuk shkarkohen në rrjedhën e poshtme të lumit.

Monitorimi i cilësisë së ujit do të kryhet në tre Njësitë Prodhuese sipas tabelës së mëposhtme, konkretisht në këto tre pika:

1. Bjefti i sipërm
2. Puset e drenazhit dhe të thellësisë
3. Bjefti i poshtëm

Matja e cilësisë së ujit pranë çdo pike dhe mostre të marrë në terren apo të kryer aty.

Prova	Metoda	Fusha e matjes
-Nitritet (NO ₂ -)	Metodë standarde ose metoda me kite	0.02-1 mg/L
-Nitratet (NO ₃ -)	Metodë standarde ose metoda me kite	1-20 mg/L
-Vlerën e pH me pajisje për matje në vend	S SH ISO 10523:2012	4-10
-Oksigjeni i tretur DO me pajisje për matje në vend	S SH EN ISO 5814:2012	0-20 mg/L
-Nevoja kimike për oksigjen COD	Metodë standarde ose metoda me kite	10-150 mg/L
-Përcaktimi i temperaturës në ujë	Termometër	0-95°C
-Përcaktimi i Nevojës Biologjike për Oksigjen BOD ₅	Metoda respirometrike	0-4000 mg/L
- Përcaktimi i Përcjellshmërisë elektrike	ISO 7888: 1985	1µS/cm - 10000 µS/cm
- Përcaktimi i lëndëve të ngurta në suspension TSS	ISO 11923:1997	2-800 mg/L
-Përcaktimi i p-PO ₄	Metodë standarde ose metoda me kite	0.05-5 mg/L

-Përcaktimi i përmbajtjes së hidrokarbureve	Metoda e gravimetrike EPA 1664B ose metoda gravimetrike të laboratorit e bazuar në këtë metodë	5-1000 mg/L
-Përcaktimi i përmbajtjes totale të yndyrave dhe grasove (TOG)	Metoda e gravimetrike EPA 1664B ose metoda gravimetrike të laboratorit e bazuar në këtë metodë	5-1000 mg/L
-Përcaktimi i përmbajtjes së hidrokarbureve	Metoda e gravimetrike EPA 1664B ose metoda gravimetrike të laboratorit e bazuar në këtë metodë	5-1000 mg/L

Shënim: fusha e matjes të jetë më e gjerë se ajo e përcaktuar në tabelën më sipër, por jo më e vogël.

Tipi matjes	Parametri	Pika matje (vend ndodhja)	Frekuenca
Mjedise të jashtme	Cilësia e ajrit CO LEL, O ₂ , VOC, H ₂ S, TSP, PM ₁₀ , PM _{2.5}	HEC Fierza (2 pikë) HEC Koman (2 pikë) HEC Vau i Dejës (2 pikë)	1 herë
	Zhurma LAeq LAmax	HEC Fierza (2 pike) HEC Koman (2 pikë) HEC Vau i Dejës (2 pikë)	1 herë
Mjedise të brendshme	Cilësia e ajrit CO LEL, O ₂ , VOC, H ₂ S, TSP, PM ₁₀ , PM _{2.5}	HEC Fierza (8 pikë) HEC Koman (8 pikë) HEC Vau i Dejës (8 pikë)	1 herë
	Zhurma LAeq LAmax	HEC Fierza (8 pikë) HEC Koman (8 pikë) HEC Vau i Dejës (8 pikë)	1 herë
Ujera	- Nitritet (NO ₂ -) - Nitratet (NO ₃ -) - Vlerën e pH me pasisje për matje në vend, -Oksigjeni I tretur DO me pajisje për matje ne vend, -Nevoja Kimike për oksigjen COD -Përcaktimi I Nevojës Biologjike për Oksigjen BOD ₅ -Përcaktimi I Përcjellshmërisë elektrike -Përcaktimi i lëndëve të ngurta në suspension TSS Përcaktimi i P-PO ₄	<ul style="list-style-type: none"> • Bjefi i sipërm • Pusët e drenazhit dhe të thellësisë • Bjefi i poshtëm 	1 herë

	- Përcaktimi i përmbajtjes së hidrokarbureve - Përcaktimi i përmbajtjes totale të yndyrave dhe grasove (TOG)		
--	---	--	--

2.5 Afati Kohor

Afati kohor për Monitorimin e Treguesve Mjedisor do të jetë 41 ditë pune si në tabelën më poshtë dhe 60 ditë kalendarike.

Nr.	Monitorimi i Treguesve Mjedisor	Monitorimi i Treguesve Mjedisor
1.	Draftimi Skedulit të kryerjes së shërbimit	5 ditë pune
2.	HEC Fierzë	8 ditë pune
3.	HEC Koman	8 ditë pune
5	HEC Vau i Dejës	8 ditë pune
6.	Raporti i Monitorimit	12 ditë pune
	Total	41 ditë pune

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti I tij/saj”.